



**RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT
TË MJEDISIT NË KOMUNËN E
PRISHTINËS - 2021**

Botues: EC Ma Ndryshe
Rr: Fehmi Lladrovci 94, Prizren
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 03 224 967

Ky dokument është realizuar nga EC Ma Ndryshe; i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" zbatuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit - CDF. Përmbajtja dhe pikëpamjet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve



Sweden
Sverige



Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave karshi 7 aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunitatet e Kosovës. Disa nga komunitetet kanë drejtoritë të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji nr.2003_3 për Pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për Mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për Produktet Biocide dhe Shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për Gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për Kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit

Ndërsa aspektet kryesore që ligjet e lartshënuara rregullojnë janë:

- Organet institucionale
- Kapacitetet njerëzore
- Dokumentet e Planifikimit dhe Menaxhimit Mjedisor
- Pjesëmarrja publike
- Të dhënat Mjedisore
- Mbikëqyrja dhe raportimi
- Licencimi, lejet dhe pëlqimet mjedisore

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor*
- Korniza ligjore*
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit*

*Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
Licencimi dhe lejet mjedisore*

Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Gjithashtu ato janë validuar nga zyrtarët përkatës komunal, si pasqyrim i gjendjes reale në sektorin e mjedisit. Njëherësh kanë theksuar se burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e Planifikimit dhe Menaxhimit Mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

1. Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prishtinës organe përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim mjedisor janë Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit (SMMA) që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Sektori për Mjedis dhe Energji Efiçente (SMEE) në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qendrueshëm.

SMMA përbëhet nga zyrtari për mjedis, zyrtari për mbeturina dhe zyrtari për mirëmbajtjen e rrugëve, ndërsa SMEE përbëhet nga Udhëheqësja e sektorit, zyrtarja për mjedis dhe zyrtarja për energji efiçente.

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim	/
Sektori	Po	Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit - SMMA	5
Zyrtarët	Po	Zyrtar për Mjedis Zyrtar për Mbeturina Zyrtar për Mirëmbajtje të Rrugëve	1 1 1

Organi komunal	A është themeluar?	Emri zyrtar	Fuqia aktuale punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm	/
Sektori	Po	Sektori për Mjedis dhe Energji Efiçiente – SMEE	3
Zyrtarët	Po	Jehona Mavraj – udhëheqëse e sektorit Fatbardha Mehmetukaj – zyrtare për mjedis Shyhrete Abazi – zyrtare për Energji Efiçiente	/

Numri i angazhuar i shërbyesve civil sipas deklaratave të zyrtarëve të SMMA nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, sipas tyre shërbyesit civil në SMMA kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara, por nuk kanë vlerësuar përgaditjen e tyre profesionale për kryerjen e këtyre detyrave. Ndërsa zyrtarët e SMEE kanë treguar se shërbyesit civil kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave me kornizën ligjore, ku nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm) u kanë dhënë vlerësimin 4/5 .

SMMA ka bërë të ditur se gjatë vitit 2021 punonjësit e këtij sektori kanë marrë pjesë në trajnime për kornizën ligjore ku kanë treguar për pjesëmarrjen në trajnimin për “Menaxhimin e Kontratave”, ndërsa SMEE ka raportuar se nuk ka organizuar trajnime të tilla. Gjithashtu në vitin 2021 nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMA, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër.

Ndërsa tek SMEE raportohet e kundërta stafi i tyre ka qenë pjesë e këtyre trajnimeve:

- Pjesëmarrja në punëtorinë “Menaxhimi i Projekteve-Kontratave Publike”, organizuar nga USAID-it për Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM) 2021.
- Pjesëmarrje në punëtorinë online (zoom) “Ekonomia Qarkore”, organizuar nga Technical Assistance and Information Exchange Instrument (TAIEX) 2021.
- Pjesëmarrje në programin trajnues “Menaxhimi i mbeturinave”, organizuar nga IKAP dhe GIZ, 2021.
- Pjesëmarrje në trajnimin “Monitorimi dhe Raportimi i PVQGJ-së, Financat e Gjelbra dhe Qytetet e Adaptueshme”, (Çertifikim) 2021.
- Pjesëmarrje në punëtorinë “Modelimi i Skenarit Urban”, organizuar nga Banka Botërore dhe ekipa e CAPSUS, 2021.
- Pjesëmarrje në punëtori dhe tryeza të ndryshme në lidhje me aspektet mjedisore siç janë: ndotja e ajrit, ujërave, tokës dhe mjedisit në përgjithësi.

Stafi i SMMA gjatë vitit 2021 kanë treguar se kanë shfrytëzuar të gjithë udhëzuesit profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por nuk ka dhënë detaje të mëtutjeshme. Ndërsa zyrtarët e SMEE kanë treguar se po i shfrytëzojnë të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

* * * * *

Statistikat Kryesore - 2021:

1. Numri i zyrtarëve të angazhuar në SMMA – 5
2. Numri i trajnimeve rreth kornizës ligjore – 1
3. Numri i trajnimeve sipas fushës mjedisore – 0
4. Numri i Udhëzuesve Profesional për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor – 0

Statistikat Kryesore - 2021:

1. Numri i zyrtarëve të angazhuar në SMEE – 3
2. Numri i trajnimeve rreth kornizës ligjore – 0
3. Numri i trajnimeve sipas fushës mjedisore – 6
4. Numri i Udhëzuesve Profesional për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor – 0

KORNIZA LIGJORE

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

SMMA ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Plani Lokal i Veprimit Mjedisor (ka skaduar, është në proces të hartimit)
2. Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (ka skaduar, është në proces të hartimit)
3. Ligji Nr. 02/L-30 për Menaxhimin e Mbeturinave
4. Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit
5. Ligji NR. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës
6. Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit

SMEE ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

1. Ligji Nr. 02/L-30 për Menaxhimin e Mbeturinave
2. Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
3. Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit
4. Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit
5. Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma
6. Si dhe Udhëzimet Administrative të cilat janë për mbrojtjen e mjedisit.

Zyrtarët e SMMA kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar. Duke treguar kështu se Rregullorja për Menaxhim të Meturinave është hartuar në vitin 2016 dhe se Plani për Menaxhim të Mbeturinave i cili ka skaduar është në proces të hartimit së bashku me Planin Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit që do jetë gati gjatë vitit 2022, po ashtu ata theksuan se shumë dokumente të tjera mjedisore mungojnë. Përgjigje për këtë pyetje nga ana e SMEE nuk kemi marrë.

Ndërsa sa i përket vlerësimit të stafit mbi njohuritë rreth kornizës ligjore SMEE nga 1/aspak -5/shkëlqyeshëm (5), i ka vlerësuar me 5, pyetje për të cilën nga SMMA nuk kemi marrë përgjigje.

HARTIMI, HARMONIZIMI DHE ZBATIMI I DOKUMENTEVE TË PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË MJEDISIT, PROJEKTEVE DHE MASAVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Nga raporti del se rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizim me qëllim që ato t'i përgjigjen nevojave të kohës. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis dhe Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave kanë skaduar dhe gjatë vitit 2022 do të hartohen planet e reja.

Programet mjedisore sipas SMEE gjatë vitit 2021 kanë përfshirë aktivitete mjedisore sipas kalendarit mjedisor, zhvillimin hartës strategjike të zhurmës, etj duke mos dhënë kështu më shumë detaje mbi to. Sipas zyrtarëve të këtij sektori (SMEE), planet lokale janë të harmonizuara me planet e nivelit qendror. SMMA ka raportuar vetëm një projekt të kontraktuar "Qendrën e Kompostimit", që është aktive që nga viti 2018 në Butoc. Ndërsa nga SMEE projektet e kontraktuara janë fushatat vetëdijësuese për Mbrojtjen e Mjedisit në shkolla të Prishtinës, Harta Strategjike e Zhurmës për zonën në Qendër të Prishtinës, hartimi i manualit për ndotjen e ajrit, zgjerimi i rrjetit të sensorëve të ajrit dhe hartimi i manualit për energji eficiente.

Masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit në vitin 2021 sipas SMMA përfshijnë pastrimin e lumenjve dhe përrockave në tërë territorin e komunës dy herë në vit, hartimin e Planit Lokal për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit dhe zvogëlimin në numër deponitë ilegale në 6 nga 146 sa ishin në vitin 2018.

Ndërsa nga SMEE si masë për mbrojtjen e mjedisit është raportuar vetëm kontrolli dhe ndëshkimet e ndërmarra nga inspeksioni. Hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit ka nevojë për përmirësim, veçmas në aspektin e nivelit të përputhshmërisë së veprimeve me strategjitë mjedisore në fuqi, ngase rrjedha aktuale e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor SMMA

Lloji i planit	Emëri i dokumentit	Statusi	Koha e hartimit	Kohëzgjatja e mandatit	Hartuesi	Disponueshmëria e raporteve të zbatimit
Planet Lokal i Veprimit në Mjedis	Plani lokal për cilësinë e ajrit	Në proces të hartimit	2022	/	Komuna e Prishtinës	/
Programet Mjedisore	/	/	/	/	/	/
Vlerësimi i Strategjik Mjedisor	/	/	/	/	/	/
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	/	/	/	/	/	/
Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Në hartim të planit të ri	2022	/	Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me GIZ	Raporti në AMMK
Plani Zhvillimor Komunal	Nuk është në kompetencë të sektorit	/	/	/	/	/
Harta Zonale e Komunës	Nuk është në kompetencë të sektorit	/	/	/	/	/
Plani i rregullimit të tokës	/	/	/	/	/	/
Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave	/	/	/	/	/	/

Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor SMEE

Lloji i planit	Emëri i dokumentit	Statusi	Koha e hartimit	Kohëzgjatja e mandatit	Hartuesi	Disponueshmëria e raporteve të zbatimit
Planet Lokal i Veprimit në Mjedis	Po		2021	5 vite	/	/
Programet Mjedisore	Aktivitete mjedisore sipas kalendarit mjedisor, hartat strategjike të zhurmes, etj	Komuna	3 muaj	/	INsi	/
Vlerësimi Strategjik Mjedisor	PZhk-ja , Plani i Mobilitetit, Plane rregulluese të hollesishme etj	Komuna	/	/	/	/
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	MMPHi	/	/	/	/	/
Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturisë	/	/	/	/	/	/
Plani Zhvillimor Komunal	/	/	/	/	/	/
Harta Zonale e Komunës	/	/	/	/	/	/
Plani i rregullimit të tokës	/	/	/	/	/	/
Programi për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave	/	/	/	/	/	/

Projektet kapitale të nivelit lokal për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit nga SMMA

Emri i projektit	Statusi	Periudha e realizimit	Vlera e kontratës	Autoriteti kontraktues	Lokacioni	Fusha temat-ike	Partneri zbatues	Plani
Qendra e kompostimit	Punët ndërtimore të përfunduara	nga 2018	Rreth 150,000 €	Komuna e Prishtinës	Butoc	Trajtimi i mbetjeve të kompostueshme	Partner në zhvillimin e projektit GIZ dhe CMSR. Derisa operimi do të realizohet nga NL Hortikultura	/

Projektet kapitale të nivelit lokal për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit nga SMEE

Emri i projektit	Statusi	Periudha e realizimit	Vlera e kontratës	Autoriteti kontraktues	Lokacioni	Fusha temat-ike	Partneri zbatues	Plani
Fushata vetëdijësuese për mbrojtjen e mjedisit në shkolla të Prishtinës	/	22 prill - 23 shtator	9,980 €	Komuna e Prishtinës	/	/	/	/
Harta Strategjike Zhurmës për zonën Qendër të Prishtinës	/	/	35,000 €	Komuna e Prishtinës	/	/	/	/
Hartimi i manualit për ndotjen e ajrit	/	/	10,000 €, në procedure	Komuna e Prishtinës	/	/	/	/
Zgjerimi i rrjetit të senzoreve të ajrit	/	/	/	Komuna e Prishtinës	/	/	/	/
Hartimi i manualit për Energji Efiçiente	/	/	6,000 €	Komuna e Prishtinës	/	/	/	/

Masat e nivelit lokal për mbrojtjen e mjedisit nga SMMA

Masat	Masat konkrete	Statusi	Periudha e realizimit	Entiteti përgjegjës	Lokacioni	Fusha tematike	Plani/Vendimi
Masat për rregullimin e pellgjeve lumore në zonat urbane;	Pastrimi i lumenjve dhe përrockav në tërë territorin e komunës, dy here në vit	Në realizim nga viti 2012	/	/	/	/	/
Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve	Nuk është në kompetencë të sektorit	/	/	/	/	/	/
Masat për mbrojtjen e vlerave të natyrës që shpall Komuna;	/	/	/	/	/	/	/
Masat emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit	Nga DSHPMSH ne vitin 2021 ka filluar hartimi i PLVCA	Plan i Veprim	2021-2022	Komuna e Prishtinës, DHPMSH, Sektori i menaxhimit të Mbeturinave dhe Ambientit	Komuna e Prishtinës	Cilesia e Ajrit	PLVCA
Masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit	Largimi i deponive ilegale në 6 nga 146 sa ishin në vitin 2018.	/	/	/	/	/	/
Lidhja e kontratës me KRM Pastrimin për ofrimin e shërbimeve në tërë territorin e komunës nga 80% sa ishte paraprakisht	/	/	/	/	/	/	/

Masat e nivelit lokal për mbrojtjen e mjedisit nga SMMA

Masat	Masat konkrete	Statusi	Periudha e realizimit	Entiteti përgjegjës	Lokacioni	Fusha tematike	Plani/Vendimi
Masat për rregullimin e pellgjeve lumore në zonat urbane;	/	/	/	/	/	/	/
Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve	Po ndëshkimet nga inspeksioni	/	/	/	/	/	/
Masat për mbrojtjen e vlerave të natyrës që shpall Komuna;	/	/	/	/	/	/	/
Masat emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit	/	/	/	/	/	/	/
Masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit	/	/	/	/	/	/	/
Lidhja e kontratës me KRM Pastrimin për ofrimin e shërbimeve në tërë territorin e komunës nga 80% sa ishte paraprakisht	/	/	/	/	/	/	/

MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR

Komuna e Prishtinës nuk ka raportuar sa i përket inspektimit dhe hartimit të raporteve mbi zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit. Nërsa sa i përket hartimit të raporteve është përgjigjur vetëm SMMA duke treguar se hartohet vetëm një raport drejtuar AMMK-së sa i përket zbatimit të Planit të Menaxhimit të Mbeturinave në baza vjetore.

Edhe gjendja e deponive të mbeturinave sipas zyrtarëve të SMMA monitorohet, por vetëm e atyre deponive ilegale pasiçë deponi të licencuara nuk ka në territorin e komunës së Prishtinës, ndërsa vlerësimi i tyre nuk realizohet.

Sa i përket monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura, përgjegjësia i është adresuar Drejtorisë së Parqeve e cila nuk ka ofruar informata për këtë çështje.

Ndërsa për monitorimin e gjendjes së pyjeve, identifikimin e çrregullimeve mjedisore, tejkalimeve të eksploatimit të resurseve natyrore dhe tejkalimeve të kushteve të vendgjuetive nuk është marrë asnjë përgjigje, pasiçë nuk janë përgjegjësi të asnjërit nga sektorët që kanë raportuar.

KRIJIMI, GRUMBULLIMI, MENAXHIMI I TË DHËNAVE DHE SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË DHËNAVE

Sipas SMMA Komuna e Prishtinës në vitin 2021 ka pasur sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, por ai më nuk është aktiv dhe se monitorimi bëhet vetëm nga stacionet e IHMK-së.

Po ashtu Komuna e Prishtinës sipas zyrtarëve të SMEE nuk ka sistem të monitorimit të dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunal të SMMA bëhet nga niveli qendror respektivisht IHMK.

Ndërsa sa i përket sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga të dy sektorët. Ndërsa sipas zyrtarëve komunalë të SMEE, nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE

Zyrtarët përgjegjës të SMEE bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të kënaqshëm. Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror nga ana e SMMA sa i përket hartimit të strategjive mjedisore, ku kanë përmendur bashkëpunimin sa i përket hartimit të Planit Lokal për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit, pastaj bashkëpunimin me IHMK, MMPHI, Komuna dhe KADC.

Sipas SMEE niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel të kënaqshëm, ku përfshihen aktivitete të ndryshme si bashkëpunimi me GIZ mbi Planin Lokal të Veprimit në Mjedis dhe për Rregulloren për Ndotjen në Mjedis dhe KADC kanë punuar mbi Planin Lokal për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit.

Sa i përket pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor SMMA ka raportuar se ka pasur dëgjim publik për Rregulloren për Menaxhimin e Meturinave dhe për ndërtimin e Qendrës së Kompostimit, por sipas tyre interesimi i qytetarëve nuk ka ekzistuar.

Edhe SMEE raporton se kanë zhvilluar procese me pjesëmarrje publike gjatë hartimit të dokumenteve si për Planin Zhvillimor Komunal, Planin e Mobilitetit, Planet e hollësishme rregulluese, VSM etj.

LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE

Sipas të dhënave të paraqitura nga SMEE në vitin 2021 janë lëshuar gjithsej 150 leje mjedisore komunale. Sa i përket licencave për çështje mjedisore nuk kemi marrë përgjigje nga asnjëri sektor.

PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij raporti janë validuar nga zyrtarët përkatës komunal, duke pohuar se ato pasqyrojnë gjendjen reale në sektorin e mjedisit, bashkë me mundësitë për të ngritur dhe përmirësuar çështjet mjedisore në këtë komunë. Burimet njerëzore dhe financiare sipas tyre nuk janë të nivelit të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Bazuar në këtë monitorim, dalin konkluzionet se:

Komuna e Prishtinës ka të krijuara organe përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, por kapacitetet njerëzore brenda këtyre organeve janë të pamjaftueshme si në aspektin kuantitativ ashtu edhe në atë profesional, ndërkohë që nuk ka pasur as aktivitete për fuqizimin e tyre në raport me kornizën aktuale ligjore, ndërsa nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMA, e kundërta ndodh tek SMEE ku nuk ka pasur aktivitete për fuqizimin e tyre në raport me kornizën aktuale ligjore ndërsa janë organizuar trajnime të shumta në lidhje me çështje mjedisore.

Njohuritë e stafit komunal rreth kornizës mjedisore nuk janë të nivelit më të lartë, derisa përcaktimi i sfidave me të cilat ata ballafaqohen si rrjedhojë e mangësive ligjore në fushën e mjedisit ka qenë i pamundur për shkak të mos listimit të tyre nga punonjësit e SMMA dhe SMEE.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematike, për faktin se Plani Lokal i Veprimit Mjedisor dhe Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave kanë skaduar dhe të dyja janë në faza të hartimit.

Niveli i inspektimit si dhe hartimi i raporteve përkatëse lidhur me zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatimit të strategjive mjedisore mbetet i paqartë për shkak të mos shpalosjes së të dhënave në këtë drejtim, derisa është pranuar se në tregues të caktuar nuk ka monitorim. Ndërkaq janë evidentuar edhe dilemat rreth përgjegjësisë, sa i përket monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura, monitorimit të gjendjes së pyjeve, identifikimit të çrregullimeve mjedisore nga aktivitete të personave fizik ose juridik, rasteve të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara, shkeljeve në menaxhimin e burimeve drusore, jodrusore dhe faunës së egër dhe tejkalimeve të kushteve të vendgjuesive.

SMMA dhe SMEE në Komunën e Prishtinës ende nuk kanë të ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore, për shkak të mungesës së resurseve teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në hartimin e politikave publike dhe bashkëpunimin me organizatat jo-qeveritare në hartimin e strategjive mjedisore vlerësohet të jetë i kënaqshëm nga ana e SMEE. Ndërsa pjesëmarrja e publikut në hartimin e strategjive lokale, mbetet i pamjaftueshëm edhe pse organizimi i proceseve zhvillohet në përputhshmëri me ligjet në fuqi.

Nga SMEE në vitin 2021 janë lëshuar gjithsej 150 leje mjedisore komunale. Sa i përket licencave për çështje mjedisore nuk kemi marrë përgjigje nga asnjëri sektor.

REKOMANDIMET

- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në SMMA dhe SMEE
- Të organizohen trajnime për punonjësit e SMMA dhe SMEE rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore.
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre.
- Të rriten kapacitetet si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.
- Të filloj sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore.
- Të avancohet bashkëpunimi në nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore.
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me OJQ-të për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore.

PËR EC:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen,
2. Qëndrueshmërinë, dhe
3. Dijen.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme.

Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;

2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.